

20
Enterprise & industrial
policy

KAPITULLI 20

Ndërmarrjet dhe politika industriale

Politika industriale e BE-së synon zhvillimin e biznesit dhe fuqizimin e industrisë përmes nxitjes së novacionit, fuqizimit të konkurrueshmërisë dhe përmirësimit të praktikave të biznesit.

Ajo përfshin udhëzime dhe standarde në tre drejtime të rëndësishme:

- a) politikat e ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- b) politika industriale; dhe
- c) masa të veçanta sektoriale për rritjen e konkurrueshmërisë.

Kuadri i BE-së në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga parime politikash, rekomandime dhe masa nxitëse të cilat nuk kërkojnë harmonizim por janë të nevojshme që të përqafohen në frymë dhe praktika për të sjellë përshtatjen strukturore të ekonomisë së Shqipërisë dhe krijimin e një kuadri të përgjithshëm që sipërmarrjet që të veprojnë në një mjedis të ndershëm dhe konkurrues.

Në mënyrë më të hollësishme politika industriale e BE-së përfshin masa dhe standarde për:

- ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)-programe dhe politika që mbështesin rritjen e NVM-ve, përfshi qasjen në financim, trajnime dhe burime.

- inovacionit dhe konkurrueshmërisë-politika për nxitjen e teknologjive të reja dhe praktikave të reja të biznesit, përfshi mbështetje për kërkim-zhvillim, me qëllim rritjen e konkurrueshmërinë së biznesit.

- industrinë e qëndrueshme-masa dhe standarde për të zhvilluar një industri të qëndrueshme duke zvogëluar ndikimin mjedisor (përfshi uljen e ndotjeve) dhe përdorimin më efikas të burimeve.

- zhvillimin rajonal-duke ndihmuar forcimin e industrisë përmes rajoneve të ndryshme dhe për të barazpeshuar mundësitë ekonomike.

- konkurrimin e ndershëm-duke parandaluar praktikatat e pandershme dhe monopolet, me qëllim krijimin e kushteve të barabarta për të gjitha bizneset.

Grupet me interes për t'u përfshirë:

Shoqatat e biznesit; dhomat e tregtisë dhe industrisë; qendrat e biznesit dhe inovacionit; institutet teknike dhe teknologjike; qendrat kërkimore.

Institucioni ndihëbeqës i negociatave:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Zhvillimit (AIDA)
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- Agjencia Kombëtare e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Financave
- Autoriteti i Konkurrencës
- INSTAT